

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE**

**PROGRAMI MËSIMOR**

**LËNDA:EDUKIMI FIZIK**

**(klasa e shtatë)**

**Tiranë, 2005**

## KLASA VII

### PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

( 35 javë x 2 orë = 70 orë )

#### 1: NJOHURI TE EDUKIMIT FIZIK (gjatë procesit mësimor)

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1	<i>Ndërtimi i aparatit mbështetës-lëvizor</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të njohim muskujt kryesorë të trungut e të legenit.</i></li> <li>▪ <i>Të dinë si t'i mbrojnë muskujt e trungut e të legenit nga dëmtimet.</i></li> </ul>	<p>➤ <i>Nxënësit (nxënëset) të jenë në gjendje të emërtojnë dhe të tregojnë me prekje vendndodhjen e muskujve kryesorë të trungut.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të emërtojnë dhe të tregojnë me prekje vendndodhjen e muskujve kryesorë të gjoksit e të shpatullave.</i></li> <li>▪ <i>Të emërtojnë dhe të tregojnë me prekje vendndodhjen e muskujve kryesorë të barkut, shpinës e të legenit.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) emërton e tregon saktë me prekje muskujt kryesorë të trungut e të legenit; ai (ajo) di si t'i mbrojë ato nga dëmtimet.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) emërton mirë, por tregon me vështirësi me prekje muskujt kryesorë të trungut e të legenit; ai (ajo) nuk di sa duhet t'i mbrojë ato nga dëmtimet.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk i emërton saktë dhe arrin të tregojë me prekje pjesërisht muskujt kryesorë të trungut e të legenit; ai (ajo) nuk di si t'i mbrojë ato nga dëmtimet.</p>
2	<i>Funksionet kryesore të aparatit mbështetës-lëvizor</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Tkurrja muskulore dhe lëvizja.</i></li> <li>▪ <i>Llojet e lëvizjeve të pjesëve të trupit në kyçe.</i></li> </ul>	<p>➤ <i>Nxënësit (nxënëset) të njohin funksionet kryesore të aparatit mbështetës-lëvizor.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të njohin tkurrjet muskulore dhe të dinë të provojnë llojet e tyre.</i></li> <li>▪ <i>Të tregojnë në praktikë llojet e lëvizjeve në kyçe dhe elementet</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) njeh e shpjegon saktë funksionet kryesore të aparatit mbështetës-lëvizor, mekanizmin e furnizimit me lëndë energjitike dhe me oksigjen të muskujve, shkaqet e lodhjes.</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Funksionimi kryesor i mushkërive dhe zemrës në furnizimin me lëndë energjitike dhe me oksigjen të muskujve.</i></li> <li>▪ <i>Pjesët kryesore të zemrës e funksionimi i saj në dy llojet e qarkullimit të gjakut.</i></li> <li>▪ <i>Pjesët kryesore të mushkërive dhe funksionet e tyre kryesore jetike.</i></li> <li>▪ <i>Lodhja muskulore dhe shkaqet e saj.</i></li> </ul>	<p><i>përbërës të llozit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të dinë si ushqehen muskujt me lëndë energjitike dhe me oksigjen.</i></li> <li>▪ <i>Të dinë serrolin kryesor në furnizimin me lëndë energjitike dhe me oksigjen të muskujve e luajnë zemra dhe mushkëritë.</i></li> <li>▪ <i>Të dinë se gjatë veprimeve lëvizore, lëndët energjitike dhe oksigjeni janë shkaku, pasoja dhe promotorët kryesorë të funksionimit normal të muskujve në të gjithë organizmin e njeriut.</i></li> </ul>	<p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e shpjegon disi funksionet kryesore të aparatit mbështetës-lëvizor, mekanizmin e furnizimit me lëndë energjitike dhe me oksigjen të muskujve; njih disi shkaqet e lodhjes.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e shpjegon disi funksionet kryesore të aparatit mbështetës-lëvizor, por nuk njih sa duhet mekanizmin e furnizimit me lëndë energjitike dhe me oksigjen të muskujve si dhe nuk është në gjendje të shpjegojë shkaqet e lodhjes.</p>
3	<i>Sjellja lëvizore e njeriut</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Zhvillimi trupor e i aftësive fizike bëhet në mënyrë të pabarabartë, brenda moshës e ndërmjet moshave.</i></li> <li>▪ <i>Lodhja fizike dhe mendore; kombinimi i pushimit me aktivitetin lëvizor e mendor.</i></li> <li>▪ <i>Emocionet e shfaqjet e tyre pozitive dhe negative. Suksesi dhe dështimi në veprimtarinë lëvizore ndikojnë në lindjen e emocioneve pozitive dhe negative.</i></li> </ul>	<p>➤ <i>Nxënësit (nxënëset) të kuptojnë vlerat e ushtrimeve fizike për jetën e përditshme, çlodhjen e për argëtimin.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të kuptojnë se zhvillimi trupor i aftësive fizike realizohet në radhë të parë përmes ushtrimeve fizike.</i></li> <li>▪ <i>Të kuptojnë se zhvillimi trupore i aftësive fizike bëhet në mënyrë të pabarabartë, brenda moshës e ndërmjet moshave.</i></li> <li>▪ <i>Të dinë pse shkaktohet lodhja fizike dhe mendore.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e shpjegon saktë vlerat e punës fizike dhe mendore në zhvillimin e përgjithshëm të njeriut. Ai (ajo) njih e shpjegon saktë shkaqet e lindjes së lodhjes fizike dhe mendore. Gjithashtu, njih e shpjegon saktë shkaqet kryesore të lindjes së emocioneve pozitive dhe negative.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e shpjegon disi vlerat e punës fizike dhe mendore në zhvillimin e përgjithshëm të njeriut. Ai (ajo) njih e shpjegon disi shkaqet e lindjes së lodhjes fizike dhe</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nuk duhet të frikësohemi nga ndryshimet trupore dhe fiziologjike të rritjes (shenjat e dyta të pjekurisë seksuale)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të dinë si të ndërthurin pushimin me veprimtarinë lëvizore.</li> <li>▪ Të kuptojnë se shkaqet kryesore të lindjes së emocioneve pozitive dhe negative janë sukcesi dhe dështimi në veprimtarinë lëvizore.</li> <li>▪ Të kuptojnë se ndryshimet trupore dhe fiziologjike janë normale dhe të natyrshme gjatë periudhës së pubertetit.</li> </ul>	<p>mendore. Gjithashtu, një e shpjegon disi shkaqet kryesore të lindjes së emocioneve pozitive dhe negative.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk njeh e nuk është në gjendje të shpjegojë si duhet vlerat e punës fizike dhe mendore në zhvillimin e përgjithshëm të njeriut. Ai (ajo) nuk njeh e nuk është në gjendje të shpjegojë shkaqet e lindjes së lodhjes fizike dhe mendore. Gjithashtu, ai (ajo) njeh e shpjegon disi shkaqet kryesore të lindjes së emocioneve pozitive dhe negative.</p>
4	Higjiena e ushtrimeve fizike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lëndët e dëmshme për shëndetin, zhvillimin fizik e shëndetsor të njeriut (duhani, alkooli, droga).</li> <li>▪ Deformimet fizike dhe mënyrat e parandalimit të tyre.</li> <li>▪ Dëmtimet kryesore fizike gjatë të ushtruarit e mënyrat e dhënies së ndihmës së parë.</li> <li>▪ Ndihmesa që japin faktorët natyrorë (dielli, ajri, uji) në shëndetin e në zhvillimin fizik të njeriut.</li> <li>▪ Roli i frymëmarrjes gjatë të ushtruarit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Nxënësit (nxënëset) të kuptojnë vlerat e higjienës së të ushtruarit fizik.</li> <li>▪ Të kuptojnë dëmet që sjellin lëndët narkotike në organizmin e njeriut.</li> <li>▪ Të njohin deformimet fizike dhe të dinë t'i parandalojnë ato.</li> <li>▪ Të njohin nivelet e ngarkesës fiziologjike gjatë të ushtruarit.</li> <li>▪ Të njohin rolin e ushqimit në rritjen e në funksionimin e organizmit.</li> <li>▪ Të kuptojnë vlerat shëndetsore të veshjes, pastërtisë së trupit e të mjedisit gjatë dhe pas të ushtruarit.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) njeh e shpjegon saktë vlerat e higjienës së të ushtruarit fizik. Ai (ajo) paraqet bindje të plota për dëmet që sjellin për zhvillimin fizik e shëndetsor lëndët e dëmshme (duhani, alkooli, droga), për ndihmesën e faktorëve natyrorë (diellit, ajrit, ujit) në shëndetin e në zhvillimin fizik të njeriut, për vlerat e ngrohjes së organizmit para të ushtruarit etj.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) njeh e shpjegon me pak ndërhyrje të mësuesit vlerat e higjienës së të ushtruarit fizik. Ai (ajo) paraqet bindje jo të qëndrueshme për dëmet që sjellin</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Ndihmesa e masazhit, dushit e qetësisë në ripërtëritjen e organizmit nga lodhja pas ushtrimeve fizike.</i></li> <li>▪ <i>Vlerat fiziologjike të ngrohjes së organizmit para të ushtruarit.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të njohin vlerat fiziologjike dhe profilaktike të ngrohjes së organizmit para të ushtruarit.</i></li> <li>▪ <i>Të kuptojnë ndihmesën e masazhit, të dushit e qetësisë në ripërtëritjen e organizmit nga lodhja pas ushtrimeve fizike.</i></li> </ul>	<p>për zhvillimin fizik e shëndetsor lëndët e dëmshme (duhani, alkooli, droga), për ndihmesën e faktorëve natyrorë (diellit, ajrit, ujit) në shëndetin e në zhvillimin fizik të njeriut, për vlerat e ngrohjes së organizmit para të ushtruarit etj.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b>  Nxënësi (nxënësja) nuk njih sa duhet e nuk është në gjendje të shpjegojë vlerat e higjienës së të ushtruarit fizik. Ai (ajo) ka bindje jo të qëndrueshme për dëmet që sjellin për zhvillimin fizik e shëndetsor lëndët e dëmshme (duhani, alkooli, droga), shpesh nënvlefëron ndihmesën e faktorëve natyrorë (diellit, ajrit, ujit) në shëndetin e në zhvillimin fizik të njeriut, si dhe vlerat e ngrohjes së organizmit para të ushtruarit.</p>
5	<i>Të ushtruarit e pavarur</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Akti dhe reagimi lëvizor.</i></li> <li>▪ <i>Veprimi lëvizor (jetësor, artificial e sportiv).</i></li> <li>▪ <i>Ushtrimi fizik.</i></li> <li>▪ <i>Cilësitë trupore (antropometrike).</i></li> <li>▪ <i>Aftësitë fizike (lëvizore).</i></li> <li>▪ <i>Mënyrat e zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore.</i></li> </ul>	<p>➤ <i>Nxënësit (nxënëset) të aftësohen për t'u ushtruar vetë, në mënyrë të pavarur.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të kuptojnë dhe të zbatojnë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor e ushtrim fizik.</i></li> <li>▪ <i>Të kuptojnë konceptet: cilësi trupore (antropometrike) dhe aftësi fizike.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b>  Nxënësi (nxënësja) kupton, shpjegon e zbaton saktë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor e ushtrim fizik. Ai (ajo) njih e zbaton 2-3 ushtrime për zhvillimin e përkulshmërisë dhe 2-3 ushtrime për zhvillimin e forcës muskulore.</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
			<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të dinë të zbatojnë rregullat kryesore të zhvillimit të përkulshmërisë dhe të forcës muskulore.</i></li> </ul>	<p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton, shpjegon e zbaton me ndërhyrjen e mësuesit konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor e ushtrim fizik. Ai (ajo) njih e zbaton 1-2 ushtrime për zhvillimin e përkulshmërisë dhe 1-2 ushtrime për zhvillimin e forcës muskulore.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk kupton e nuk është në gjendje të shpjegojë e të zbatojë konceptet: akt lëvizor, veprim lëvizor e ushtrim fizik. Ai (ajo) nuk njih e nuk di të zbatojë asnjë ushtrim për zhvillimin e përkulshmërisë (ose të forcës muskulore), por njih e zbaton me mangësi 1 ushtrim për zhvillimin e forcës muskulore (ose të përkulshmërisë).</p>
6	<i>Lëvizja olimpike</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Fillesat e olimpiadave të lashtësisë. Si u organizuan ato.</i></li> <li>▪ <i>Qëllimet e vlerat e olimpizmit klasik.</i></li> <li>▪ <i>Karakteristikat organizative dhe ideore të olimpiadave moderne.</i></li> <li>▪ <i>Loja e ndershme-thelbi i filozofisë olimpike.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Nxënësit (nxënëset) të kuptojnë se lëvizja olimpike është me synime edukative universale.</i></li> <li>▪ <i>Të dinë si lindën e si u organizuan olimpiadat e lashtësisë.</i></li> <li>▪ <i>Të kuptojnë qëllimet kryesore dhe karakteristikat e organizimit të olimpiadave në kohën e sotme.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton e shpjegon saktë karakterin edukativ universal të lëvizjes olimpike. Ai (ajo) është në gjendje të tregojë thelbin e filozofisë olimpike.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton e shpjegon me pak ndërhyrje të mësuesit karakterin edukativ universal të lëvizjes</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
			<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të kuptojnë se loja e ndershme në sport përbën një nga virtytet themelore të çdo pjesmarrësi.</i></li> </ul>	<p>olimpike. Ai (ajo) është në gjendje të tregojë me ndonjë mangësi të vogël thelbin e filozofisë olimpike.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b>  Nxënësi (nxënësjja) nuk kupton e shpjegon jo qartë karakterin edukativ universal të lëvizjes olimpike. Ai (ajo) është në gjendje të tregojë përciptazi thelbin e filozofisë olimpike.</p>

## 2.- VEPRIME LËVIZORE BAZË

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1	Me topa të mbushur 1 kg	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shtytja e topit me një dorë nga supi (majtë, djathtë) në largësi.</li> <li>▪ Hedhja e topit me një dorë (nga poshtë) në largësi (majtë, djathtë).</li> <li>▪ Shtytje, hedhje dhe pritje e topit në largësi me shokun.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të shtyjnë dhe të hedhin (me të majtën e me të djathtën), duke shfaqur qartë forcën dinamike dhe duke arritur rezultat, që rritet gradualisht në largësi (m).</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) e shtyn dhe e hedh topin, duke shfaqur qartë forcën dinamike dhe rritje të rezultatit.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) e shtyn dhe e hedh topin, duke shfaqur rritje të vogël të rezultatit, nga hedhja (shtytja) në hedhje (shtytje).</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) e shtyn dhe e hedh topin, por nuk shfaq rritje të rezultatit. Ai (ajo) ka stabilitet nga hedhja (shtytja) në hedhje (shtytje).</p>
2	Me gantele të vogla 500gr (dy gantele)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nga qëndrimi me gantelet poshtë, përkulje dhe shtrirje e krahëve para, lart, anash e përsëri poshtë.</li> <li>▪ Nga qëndrimi me gantelet poshtë, përkulje e trungut para, krahët anash e drejtim përsëri në P.F.</li> <li>▪ Nga qëndrimi me gantelet poshtë, qëndrime statike, me krahët para dhe me krahët anash, që shoqërohen me përkulje dhe drejtim të këmbëve (këmbëmbledhje dhe drejtim në P.F.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të kryejnë me saktësi (veças) ushtrimet me gantele 500 gr.</li> <li>▪ Të rrisin gradualisht qëndrueshmërinë e forcës dinamike dhe statiko-dinamike, duke matur vëllimin e kohës së punës.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me saktësi dhe dinamizëm të tri veprimet lëvizore (veças), duke shfaqur qartë qëndrueshmëri të forcës.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen të tri veprimet lëvizore (veças), duke shfaqur qëndrueshmëri më të ulët të forcës.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen të tria veprimet lëvizore (veças), duke shfaqur qëndrueshmëri më të ulët (se niveli B) të forcës.</p>



Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
3	Vrapime të lira aerobike (pistë, palestër, shesh).	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vrapim i lirë aerobik në largësi të ndryshme.</li> <li>▪ Vrapim i lirë, i ndërthurur me pengesa të ndryshme sportive ose natyrore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të bashkërendojnë lëvizjet e ekstremiteteve me frymëmarrjen e rregullt gjatë vrapimit me ose pa pengesa.</li> <li>▪ Të rrisin gradualisht largësinë e vrapimit, duke e përshkuar atë me të njejtën kohë (vrapim me kohë).</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) bashkërendon mirë lëvizjet gjatë vrapimit e brenda kohës së caktuar, rrit mjaft dukshëm largësinë.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) bashkërendon lëvizjet gjatë vrapimit e brenda kohës së caktuar, rrit pak largësinë.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) bashkërendon lëvizjet gjatë vrapimit e brenda kohës së caktuar, ruan të njejtën largësi.</p>
4	Kërcime të lira me litarin vetjak e me atë kolektiv (të gjatë).	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kërcime në vend, duke e rrotulluar litarin para, prapa dhe me kryqëzim të krahëve para.</li> <li>▪ Kërcime në grup (2-3 veta) me litarin e gjatë, me hyrje dhe dalje anësore dhe ballore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të bashkërendojnë lëvizjet e ekstremiteteve me ato të litarit.</li> <li>▪ Të kryejnë kërcimet në grup, pa gabuar në hyrjen e në daljen nga litari.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me sukses kërcimet e gabon rrallë, kur koha e kërcimeve zgjatet mbi 3 minuta.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen kërcimet e gabon, kur koha e kërcimeve zgjatet mbi 2 minuta.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> kryen kërcimet e gabon, kur koha e kërcimeve zgjatet mbi 1 minutë</p>
5	Lëvizje kundërvepruese	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Tërheqje dyshe me shkop ose litar vetjak.</li> <li>▪ Shtytje e shokut përballë, me dy duar të lidhura te gishtërinjtë.</li> <li>▪ Ngjitje në litarin e varur, me këmbë dhe me duar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të kryejnë veprimet kundërvepruese për disa sekonda.</li> <li>▪ Të ushtrohen për rritjen e qëndrueshmërisë statike dhe statiko-dinamike.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen veprimet, duke shfaqur qëndrueshmërinë e forcës për një kohë që vjen duke u rritur.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen veprimet, duke shfaqur qëndrueshmërinë e forcës, por ka vështirësi në ngjitjen në litarin e varur.</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
				<p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen veprimet, duke shfaqur dobësi në qëndrueshmërinë e forcës e duke mos arritur të ngjitet 2 m në litarin e varur.</p>
6	<p><i>Baraspeshimi statik e dinamik. i trupit</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Ecje mbi traun e baraspeshimit (mbi stolin gjimnastikor) me topa tenisi të mbajtur mbi pëllëmbë, me krahë të shtrirë anash.</i></li> <li>▪ <i>Qëndrim mbi një gjysmësferë mbi dy këmbët, me qese rëre mbi kokë.</i></li> <li>▪ <i>Ecje mbi një vijë të drejtë, me topin e mbushur mbi kokë.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të kryejnë me sukses veprimet e baraspeshimit.</i></li> <li>▪ <i>Të kultivohet baraspeshimi statik e dinamik, duke rritur kohën e ruajtjes së tij.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen veprimet, duke rritur dukshëm, nga prova në provë, kohën e ruajtjes së baraspeshimit.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen veprimet, por rrit më pak kohën e ruajtjes së baraspeshimit</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen veprimet, por kohën e baraspeshimit e ruan të stabilizuar (pa rritje nga prova në provë).</p>

### 3:- MANIPULIM LËVIZJESH

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1	Ushtrime me top	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të vendosur në grupe prej tre vetash, nxënësi i mesit bën pasime të topit para dhe prapa.</li> <li>▪ Nga qëndrimi me topin lart me dorën e djathtë (të majtë), lëshim e pritje e tij, përpara se ai të prekë tokën.</li> <li>▪ Shkelmim i lehtë i topit para dhe kalim i tij me vrapim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të aftësohen në bashkërendimin lëvizor.</li> <li>▪ Të fitojnë refleksin e goditjeve dhe të pritjeve të topit me pjesë të ndryshme të trupit.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me sukses 6 pasime të topit para dhe prapa, duke qenë i vendosur midis dy shokëve; pret (4 herë, në 6 tentativa) topin përpara se ai të prekë tokën, nga qëndrimi me të lart (me të djathtën ose të majtën); kalon me vrapim tri herë topin e shkëlmuar para, në tri tentativa.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me sukses 4 pasime të topit para dhe prapa, duke qenë i vendosur midis dy shokëve; pret (3 herë, në 6 tentativa) topin përpara se ai të prekë tokën, nga qëndrimi me të lart (me të djathtën ose të majtën); kalon me vrapim dy herë topin e shkëlmuar para, në tri tentativa.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me vështirësi 2 pasime të topit para dhe prapa, duke qenë i vendosur midis dy shokëve; pret (1 herë, në 6 tentativa) topin përpara se ai të prekë tokën, nga qëndrimi me të lart (me të djathtën ose të majtën); kalon me vrapim një herë topin e shkëlmuar para, në tri tentativa.</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
2	Ushtime me shkopinj gjimnastikorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kalim me hapa të mëdhenj i shkopinjve që mbahen nga shokët horizontalisht, në lartësinë 20 cm.</li> <li>▪ Kalim me kërcime i shkopinjve që mbahen nga shokët horizontalisht, në lartësinë 20 cm.</li> <li>▪ Kalim me kërcime i shkopinjve që mbahen nga shokët horizontalisht, në lartësinë 20-30 cm (shkopi i parë 20 cm, i dyti 30 cm e kështu me radhë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të aftësohen në ndjeshmërinë e baraspeshimit të tkurrjeve muskulore.</li> <li>▪ Të edukohen me ndjenjën e bashkëveprimit në grup, përmes veprimeve sy-mjet..</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me sukses kalimin me hapa të mëdhenj e me kërcime mbi 8 shkopinj, të mbajtur nga shokët horizontalisht (jo më afër se 70 cm me njëri-tjetrin) në lartësinë 20-30 cm (I, III, V, VII etj. në lartësinë 20 cm; II, IV, VI, VIII etj. në lartësinë 30 cm)</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen kalimin me hapa të mëdhenj e me kërcime të paktën 6 shkopinj, të mbajtur nga shokët horizontalisht (jo më afër se 70 cm me njëri-tjetrin) në lartësinë 20-30 cm (I, III, V në lartësinë 20 cm; II, IV, VI në lartësinë 30 cm).</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me shumë vështirësi kalimin me hapa të mëdhenj e me kërcime 4 shkopinj, të mbajtur nga shokët horizontalisht (më afër se 70 cm me njëri-tjetrin) në lartësinë 20 cm .</p>
3	Ushtime me rrathë (gjimnastikorë dhe të vegjël)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nga qëndrimi përballë shokut, në largësinë 2-3 m, hedhje e rrethit të vogël me njerën (të djathtën ose të majtën) te shoku dhe pritje me dorën tjetër e rrethit të vogël të hedhur nga shoku (4-6 cikle të plota).</li> <li>▪ Kalim këmbadorsai (brenda rrethit) i 4-8 rrathëve gjimnastikorë të vendosur (të mbajtur nga shokët)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të aftësohen në parashikimin lëvizor, në lidhje me shokun e me objektin.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kryen me sukses 6 cikle të plota të hedhjes e pritjes së rrethit të vogël, nga qëndrimi përballë shokut, në largësinë 3m (e hedh me të djathtën dhe e pret me të majtën); kalon këmba-dorazi 8 rrathë gjimnastikorë të vendosur (të mbajtur nga shokët) vertikalisht jo më larg se 3 m nga njeri-tjetri; hedh me precision 4 rrathë të</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
		<p><i>vertikalisht, jo më larg se 3 m nga njëri-tjetri.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Hedhje e rrethit të vogël me saktësi në shkopin që mbahet nga shoku përballë, të vendosur në largësinë 2-3 m.</i></li> </ul>		<p>vegjël (nga 5 tentativa) në shkopin e mbajtur nga shoku, i cili është i vendosur në largësinë 3m.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b>  Nxënësi (nxënësja) kryen me sukses 5 cikle të plota të hedhjes e pritjes së rrethit të vogël, nga qëndrimi përballë shokut, në largësinë 2 m (e hedh me të djathtën dhe e pret me të majtën); kalon këmbadorasi 6 rathë gjimnastikorë të vendosur (të mbajtur nga shokët) vertikalisht pak më larg se 3 m nga njëri-tjetri; hedh me saktësi 2 rathë të vegjël (nga 5 tentativa) në shkopin e mbajtur nga shoku, i cili është i vendosur në largësinë 3 m.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b>  Nxënësi (nxënësja) kryen me vështirësi 4 cikle të plota të hedhjes e pritjes së rrethit të vogël, nga qëndrimi përballë shokut, në largësinë 2 m (e hedh me të djathtën dhe e pret me të majtën); kalon këmbadorasi 4 rathë gjimnastikorë të vendosur (të mbajtur nga shokët) vertikalisht 4 m larg nga njëri-tjetri; hedh me saktësi 1 rreth të vogël (nga 5 tentativa) në shkopin e mbajtur nga shoku, i cili është i vendosur në largësinë 3 m.</p>
4	<p><i>Ushtrime me birila (shishe gjimnastikore)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vrapim gjarpëror, me kalimin e 6-10 birilave, të vendosura në largësinë 1.5-3 m njëra pas tjetrës.</i></li> <li>▪ <i>Vrapim me kapërcim (një herë me të majtën e një herë me këmbën</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të zhvillojnë, deri në nivelin e shkathtësisë, aftësitë lëvizore të ecjes (në forma dhe drejtime të ndryshme), të vrapimit e të kapërcimit të pengesave.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b>  Nxënësi (nxënësja) kalon me vrapim gjarpëror 10 birila, të vendosura në largësinë 1,5 m njëra pas tjetrës; kapërcen me vrapim 8 birila, të</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
		<p>e djathtë) të 4-8 birilave, të vendosura në largësinë 60-80 cm njëra pas tjetrës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ecje gjarpërore me drejtim prapa, me kalimin e 4-8 birilave, të vendosura 1.5-2 m njëra pas tjetrës.</li> </ul>		<p>vendosura 80 cm larg njëra-tjetrës.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kalon me vrapim gjarpëror 8 birila, të vendosura në largësinë 2 m njëra pas tjetrës; kapërcen me vrapim 6 birila, të vendosura 70 cm larg njëra-tjetrës.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kalon me vështirësi, me vrapim gjarpëror 6 birila, të vendosura në largësinë 3 m njëra pas tjetrës; kapërcen me vrapim më pak se 4 birila, të vendosura 60 cm larg njëra-tjetrës.</p>
5	<p>Ushtrime me shokun (ose në grup)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit të vendosur në grupe prej 3-4 vetash, 70-80 cm njëri pas tjetrit, me këmbë të hapura anash, i fundit kalon këmbadorasi në krye të grupit (me kohë).</li> <li>▪ Nxënësit të vendosur në grupe prej 3-4 vetash, 1,5-2 m njëri pas tjetrit, në drejtqëndrim, i fundit kalon me ecje të shpejtë gjarpërore në krye të grupit (me kohë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të aftësohen për bashkëveprim lëvizor në hapsirë dhe në kohë me shokun (me grupin).</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kalon për 5 sek. këmbadorasi nën këmbët e hapura anash të 4 shokëve, të vendosur 80 cm njëri pas tjetrit.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kalon për 6 sek. këmbadorasi nën këmbët e hapura anash të 4 shokëve, të vendosur 80 cm njëri pas tjetrit.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) kalon me vështirësi për 7 sek. këmbadorasi nën këmbët e hapura anash të 4 shokëve, të vendosur 70 cm njëri pas tjetrit.</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
6	Ushtrime me top voleibolli	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit të vendosur në një kolonë, me këmbë të hapura anash. Kalim nga fundi në fillim i topit, me të dyja duart, ndërmjet këmbëve të shokut para. Kthim i topit në pozicionin fillestar majtas e djathtas.</li> <li>▪ Me anë të një pëlhure të tendosur në duar, hedhje e topit lart e pritje e tij, me krahët lart-para, pas kthimit 180°-360°.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të aftësohen për orientimin e për diferencimin e lëvizjeve, duke realizuar bashkëveprimin sy-objekt dhe sy-objekt-shok.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja), me anë të një pëlhure të tendosur në duar, hedh lart e pret (4 herë nga 5 tentativa) topin, me krahët lart-para, pas kthimit 360° (majtas ose djathtas).</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja), me anë të një pëlhure të tendosur në duar, hedh lart e pret (3 herë nga 5 tentativa) topin, me krahët lart-para, pas kthimit 360° (majtas ose djathtas).</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja), me anë të një pëlhure të tendosur në duar, hedh lart e pret (2 herë nga 5 tentativa) topin me vështirësi, me krahët lart-para, pas kthimit 180° (majtas ose djathtas).</p>
7	Ushtrime me pjatelë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nga qëndrimi me shokun përballë, në largësinë 10-14 m, hedhje e pjatelës shokut me dorën e djathtë dhe të majtë.</li> <li>▪ Hedhje me saktësi e pjatelës, me goditje të birilës së vendosur në largësinë 8-12 m.</li> <li>▪ Hedhje me saktësi e pjatelës në një rreth me diametër 1 m, të vendosur (ose të vizatuar në tokë) në largësinë 8-12 m..</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të aftësohen për të tkurrur muskujt në regjimin dinamik e për të kryer lëvizjet me saktësi.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) ia hedh me saktësi pjatelën shokut përballë, në largësinë 14m, me dorën e djathtë dhe të majtë; hedh me saktësi pjatelën, duke goditur birilën (3 herë, nga 5 tentativa), të vendosura në largësinë 12 m.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) ia hedh jo gjithnjë me saktësi pjatelën shokut përballë, në largësinë 12 m, vetëm me dorën e djathtë (ose të majtë); hedh jo gjithnjë me saktësi pjatelën, duke goditur birilën (2 herë, nga 5 tentativa), të vendosura në largësinë 10m.</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
				<p><b>C.- Niveli i ulët:</b>            Nxënësi (nxënësja) ia hedh jo me saktësi pjetelën shokut përballë, në largësinë 10 m, vetëm me dorën e djathtë (ose të majtë); hedh jo me saktësi pjetelën, duke goditur jo gjithnjë birilën (vetëm 1 herë, nga 5 tentativa), të vendosura në largësinë 10 m.</p>
8	<i>Ushtrime me top tenisi</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Goditje me saktësi e rrathëve të vizatuar në mur (me diametër nga 40-60 cm), në largësi që vjen duke u rritur (nga 2-4 m).</i></li> <li>▪ <i>Goditje me saktësi e birilave, në largësi që vjen duke u rritur (nga 2-4 m).</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të aftësohen deri në nivelin e shkathtësisë për mënyrën e hedhjes së topit e për parashikimin lëvizor.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b>            Nxënësi (nxënësja) godet (3 herë, nga 5 tentativa) me saktësi një rreth të vizatuar (me diametër 40 cm), në largësinë 3-4 m; godet me saktësi (3 herë, nga 5 tentativa) birilën të vendosur 3-4 m larg.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b>            Nxënësi (nxënësja) godet (2 herë, nga 5 tentativa) një rreth të vizatuar (me diametër 50 cm), në largësinë 2-3 m; godet (2 herë, nga 5 tentativa) birilën të vendosur 2-3 m larg.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b>            Nxënësi (nxënësja) godet (1 herë, nga 5 tentativa) një rreth të vizatuar (me diametër 60 cm), në largësinë jo më shumë se 2 m; godet (1 herë, nga 5 tentativa) birilën të vendosur jo më shumë se 2 m larg.</p>



#### 4.- LOJËRA LËVIZORE POPULLORE

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1	Lojëra të forcës së shpejtë (ciklike, aciklike dhe të përziera)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ “Topi i helmuar”.</li> <li>▪ “Kush vjen vonë, mbetet jashtë”.</li> <li>▪ “Kalaja dibrançe”.</li> <li>▪ “Jesirthi”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të respektojnë rregullat e lojërave, duke shfaqur aftësinë e forcës së shpejtë.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq qartë forcë të shpejtë dhe bashkëpunon me shokët në të gjitha lojërat e mësuara.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) në dy-tri lojëra shfaq cilësinë e forcës së shpejtë dhe bashkëpunon mire me shokët.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq dobët aftësinë e forcës së shpejtë gjatë lojërave.</p>
2	Lojëra të reagimit të shpejtë dhe të vëmendjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ “Symbyllurazi”.</li> <li>▪ “Stafetë me topa”.</li> <li>▪ “Rrëmbimi i shamisë”.</li> <li>▪ “Rrokja belas”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të zhvillojnë reagimin e shpejtë dhe të jenë të vëmendshëm në kryerjen e veprimeve të lojërave që mësojnë.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) në 4 lojërat, shfaq qartë reagimin e shpejtë dhe vëmendje të plotë.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq qartë reagimin e shpejtë dhe vëmendje të plotë, por në 2-3 lojëra të mësuara.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq reagimin e shpejtë dhe vëmendje të plotë, por në 1-2 lojëra të mësuara.</p>
3	Lojëra të qëndrueshmërisë aerobike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ “Rrjeta e peshkatarit”.</li> <li>▪ “Bufi, kllonça dhe zogjtë”.</li> <li>▪ “E ka kush e ka”.</li> <li>▪ “Dhelpra e çalë”.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të zhvillojnë qëndrueshmërinë aerobike dhe të respektojnë rregullat e lojërave.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) në 4 lojërat, shfaq qartë bashkëpunimin me shokët e qëndrueshmërinë aerobike.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq qartë bashkëpunimin me shokët e qëndrueshmërinë aerobike, në 3 lojëra</p>

Nr.	NËNLINJA	PERMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
				<p>të mësuara.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq bashkëpunimin me shokët e qëndrueshmërinë aerobike, në 2 lojëra të mësuara.</p>
4	<p><i>Lojëra të qëndrueshmërisë së forcës dinamike</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>“Tërheqja me shkop”.</i></li> <li>▪ <i>“Kush e shtyn më larg topin” (me peshë 2 kg).</i></li> <li>▪ <i>“Stafetë me kapërcim pengesash”.</i></li> <li>▪ <i>“Nxirre shokun nga rrethi” (diametri 2 m).</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të aktivizohen gjallërisht e të zhvillojnë qëndrueshmërinë e forcës dinamike, duke respektuar rigorozisht rregullat e lojërave.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) në 4 lojërat, shfaq qartë qëndrueshmërinë e forcës dinamike.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq qartë qëndrueshmërinë e forcës dinamike, por në 3 lojëra të mësuara.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) shfaq qëndrueshmërinë e forcës dinamike, por në 2 lojëra të mësuara.</p>

## 5.- VALLËZIM RITMIK

Nr.	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1	<i>Përshtatja me ushtrimet në levë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Lëvizjet me hap para, mbështetur në levë majtas e djathtas.</i></li> <li>▪ <i>Të njëjtat lëvizje, të shoqëruara me lëvizjen e krahëve.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të marrin njohuri lidhur me lëvizjet e këmbës para, e majtë dhe djathtë.</i></li> <li>▪ <i>Të marrin njohuri në lidhje me bashkërendimin.</i></li> </ul>	<p><b>A-Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) ka njohuri të mira lidhur me lëvizjet e këmbëve dhe të krahëve.</p> <p><b>B- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) ka njohuri të mjaftueshme lidhur me lëvizjet e këmbëve dhe të krahëve.</p> <p><b>C-Niveli i ulët</b> Nxënësi (nxënësja) ka njohuri minimale.</p>
2	<i>Përshtatja me dy hapat vallëzues majtas e djathtas.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Dy hapa mjasat e dy të tjera djathtas.</i></li> <li>▪ <i>Përpunimi i dy hapave vallëzues majtas e djathtas.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të mësojnë mënyrën e lëvizjeve anësore, me hapa në formë vallëzimi.</i></li> <li>▪ <i>Të përsosin lëvizjen vallëzuese, me dy hapa anësorë.</i></li> </ul>	<p><b>A-Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) realizon në mënyrë të saktë dy lëvizje anësore majtas e djathtas.</p> <p><b>B- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) i realizon ato mjaftueshëm.</p> <p><b>C-Niveli i ulët</b> Nxënësi (nxënësja) i realizon ato në nivelin minimal.</p>
3	<i>Mësimi i dy hapave vallëzues para dhe prapa</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Lëvizja vallëzuese me dy hapa para dhe prapa.</i></li> <li>▪ <i>Përpunimi i dy hapave vallëzues para dhe prapa.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të kryejnë lëvizjen vallëzuese, me dy hapa para dhe prapa.</i></li> <li>▪ <i>Të përsosin lëvizjen vallëzuese, me dy hapa para dhe prapa.</i></li> </ul>	<p><b>A-Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) realizon me saktësi hapat vallëzuese para dhe prapa.</p> <p><b>B- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) i realizon ato mjaftueshëm.</p> <p><b>C-Niveli i ulët</b> Nxënësi (nxënësja) i realizon ato në nivel minimal.</p>

Nr.	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
4	<i>Lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, majtas e djathtas.</i>	▪ <i>Mësimi i lëvizjeve vallëzuese çka-çka majtas e djathtas.</i>	▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të kryejnë lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, majtas e djathtas.</i>	<p><b>A-Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) ekzekuton mjaft mirë lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka.</p> <p><b>B- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) i ekzekuton ato mjaftueshëm.</p> <p><b>C-Niveli i ulët</b> Nxënësi (nxënësja) i realizon ato të rregullta.</p>
5	<i>Lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, para dhe prapa.</i>	▪ <i>Mësimi i lëvizjeve vallëzuese çka-çka , para dhe prapa.</i>	▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të kryejnë lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, para dhe prapa.</i>	<p><b>A-Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) ekzekuton shkëlqyeshëm lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, para dhe prapa.</p> <p><b>B- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) i ekzekuton ato në nivel mesatar.</p> <p><b>C-Niveli i ulët</b> Nxënësi (nxënësja) i ekzekuton ato dobët.</p>
6	<i>Gërshetimi i lëvizjeve vallëzuese çka-çka-çka.</i>	▪ <i>Mësimi i gërshetimit të lëvizjeve vallëzuese çka-çka-çka, në të gjitha anët.</i>	▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të kryejnë lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, në të gjitha anët.</i>	<p><b>A-Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) i ekzekuton saktësisht këto lëvizje.</p> <p><b>B- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) i ekzekuton mjaftueshëm lëvizjet vallëzuese çka-çka-çka, në të gjitha anët.</p> <p><b>C- Niveli i ulët</b> Nxënësi (nxënësja) i ekzekuton ato dobët.</p>

## 6.1.- BASKETBOLL

NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
Njohuri	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Historiku i lojës së minibasketit në botë e në vendin tonë.</li> <li>▪ Rregullore e lojës së basketbollit (gjqtarët, pajisjet, shenjat).</li> <li>▪ Kërkesat kryesore të rregullores në ekzekutimin e elementeve teknike të mësuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të njohin të dhëna të sakta për historikun e lojës së minibasketit në botë dhe në vendin tonë.</li> <li>▪ Të zbatojnë kërkesat e rregullores teknike për elementet që mësohen.</li> <li>▪ Të njohin shenjat e gjyqtarit e të reagojnë ndaj tyre.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) ka njohuri të mira për historikun e lojës e ekzekuton drejt elementet teknike. Njeh e zbaton drejt rregulloren teknike të mësuar.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) njeh historikun e lojës, kupton drejt kërkesat e rregullores teknike, por ka vështirësi në demonstrim.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) ka njohuri për historikun, por nuk njeh e nuk ekzekuton elementet teknike dhe të rregullores.</p>
Pasimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kapje dhe pasim me dy duar nga krahërori në vend.</li> <li>▪ Kapje dhe pasim me dy duar nga krahërori në këvizje.</li> <li>▪ Kapje dhe pasim me një dorë nga supi.</li> <li>▪ Kapje dhe pasim me dy duar nga sipër kokës.</li> <li>▪ Kapje dhe pasim me dy duar, me përplasje në tokë.</li> <li>▪ Kapje dhe pasim me një dorë, me përplasje në tokë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxënësit (nxënëset) të zotërojnë topin e të pasojnë, sipas standardeve teknike.</li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton e ekzekuton elementet teknike të pasimit, sipas standardit të kërkuar; pason në mur mbi 23 herë për 30 sek.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton skemën lëvizore të ekzekutimit të elementeve teknike të pasimit, por ka mangësi në ekzekutim; pason në mur 16-22 herë për 30 sek.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk ekzekuton elementet teknike, sipas standardit të kërkuar; pason në mur 10-15 herë për 30 sek.</p>

NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
<i>Driblimet</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Driblimi në lëvizje, në vijë të drejtë.</i></li> <li>▪ <i>Driblim, me ndryshim drejtimi.</i></li> <li>▪ <i>Driblim, me ndryshim ritmi.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të realizojnë elementin teknik të driblimit, sipas kërkesave përkatëse teknike.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton e ekzekuton elementin teknik të <i>driblimit</i>, sipas standardit të kërkuar.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton skemën lëvizore të ekzekutimit, por ka mangësi në standardin e kërkuar gjatë ekzekutimit.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk ekzekuton elementin teknik, sipas standardit të kërkuar.</p>
<i>Kthimet</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Kthimet në vend e në lëvizje.</i></li> <li>▪ <i>Kthimet me dhe pa top.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të realizojnë kthimet sipas satandarreve teknike.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton e ekzekuton elementin teknik të <i>kthimit</i> sipas standardit të kërkuar.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) kupton skemën lëvizore të ekzekutimit, por ka mangësi në standardin e këkuar gjatë ekzekutimit.</p> <p><b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk ekzekuton elementin teknik sipas standardit të kërkuar.</p>
<i>Gjuajtjet</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Gjuajtjet me një dorë nga supi.</i></li> <li>▪ <i>Gjuajtjet nga vendi me një dorë para, me ½ kërcim.</i></li> <li>▪ <i>Gjuajtje në lëvizje me një dorë nga poshtë.</i></li> <li>▪ <i>Gjuajtje në lëvizje me një dorë nga sipër.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të kryejnë gjuajtje nga vendi, në largësi të afërt, mesatare dhe nga larg sipas standardit teknik.</i></li> </ul>	<p><b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) ekzekuton në lojë elementet teknike të mësuar sipas standardeve përkatëse të kërkuara.</p> <p><b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) gjatë lojës paraqet mangësi në ekzekutimin e elementeve të veçanta teknike të</p>

			mësuara. <b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk ekzekuton elementet teknike, sipas standardit të kërkuar.
<i>Lojë mësimore</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Lojë 1x1, me një tabelë.</i></li> <li>▪ <i>Lojë mësimore 2x2.</i></li> <li>▪ <i>Lojë mësimore 3x3.</i></li> <li>▪ <i>Lojë mësimore 5x5.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të zbatojnë elemente të rregullores teknike të lojës.</i></li> </ul>	<b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e zbaton elementet teknike të mësuara e të rregullores. <b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) ekzekuton pjesërisht elementet e mësuara. <b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk njih e nuk zbaton (ekzekuton) elementet teknike të mësuara e të rregullores.
<i>Gjykim loje</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të lojërave mësimore.</i></li> <li>▪ <i>Të lojërave 5x5 në veprimtaritë sportive jashtë mësimin.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) të dallojnë dhe të reagojnë në shkeljen e rregulloreve.</i></li> <li>▪ <i>Të interpretojnë shenjat e gjyqtarit.</i></li> </ul>	<b>A.- Niveli i përparuar:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e zbaton elementet teknike të mësuara e të rregullores sipas standardeve dhe kërkesave përkatëse. <b>B.- Niveli mesatar:</b> Nxënësi (nxënësja) njih e ekzekuton pjesërisht elementet teknike të mësuara dhe të rregullores. <b>C.- Niveli i ulët:</b> Nxënësi (nxënësja) nuk njih e nuk zbaton (ekzekuton) elementet teknike të mësuara e të rregullores.

### 6.3.- ATLETIKË

Nr.	NËNLINJA	PËRMBAJTJA	OBJEKTIVAT	ARRITJET
1	<b>VRAPIMET</b>			
1.1	<i>Vrapime shpejtësie</i>	<p><i>Ushtrime speciale vrapimi:</i>            - vrapim me hapa te vegjël            - vrapim me hap kërcyes  <i>Pëshpejttime në gjatësi 20-30 m mbi vija të drejta</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nisje nga pozicione te ndryshme pas sinjalit dëgjimor, vrapim 5-10 m.</i></li> <li>- <i>Nisje nga pozicioni në këmbë</i></li> <li>- <i>vrapime në gjatësi 30-50 m</i></li> <li><i>Nisje me komandë, nga pozicioni me një dorë në tokë, vrapim 20- 30 m</i></li> <li>▪ <i>Stafeta të ndryshme në formë lojërash</i></li> <li>▪ <i>Stafeta sportive 4x50 m</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Nxënësit (nxënëset) te mësojnë ushtrime të tjera speciale, si pjesë e teknikës së plotë të vrapimit</i></li> <li>▪ <i>Të vendosin këmbët në tokë në të njëjtën vijë, si dhe këmbët të kryhejnë lëvizje rrotulluese gjatë vrapimit</i></li> <li>▪ <i>Të krijojnë ndjesinë e përkuljes së trupit para dhe shtytjes në kënd të ngushtë.</i></li> </ul>	<p><b>A. Nivel i përparuar</b>            Reagon mirë, në nisje ruan prirjen (përkuljen) e trupit përpara, ndërthur mirë lëvizjet e këmbëve e të duarve. Ka përmirësim të ndjeshëm të kohës vet në 50 m.</p> <p><b>B. Niveli mesatar</b>            Në përgjithësi i realizon mirë të gjithë elementet teknike, por ka ndonjë mangësi nga ato të përmendura më sipër , apo përmirësim të vogël të kohës vetjake në 50 m.</p> <p><b>C. Nivel i dobët</b>            Reagim i dobët, mungesë të ndërthurjes së bashkëveprimit, përmirësim i vogël i kohës vetjake në 50 m</p>
1.2	<i>Vrapime qëndrueshmërie</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vrapim "gallop" 30-40 m x 2-4 përsëritje.</i></li> <li>▪ <i>Vrapim me hap kërcyes në larg. 30-40m x 2-4 përsëritje.</i></li> <li>▪ <i>Vrapime në grupe me aftësi të përafërta, 400 m (50 m vrapim – 50 m ecje) x 2-4 përsëritje.</i></li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vrapim deri në 12 min.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Në stafeta vrapohet me ritëm shumë të lartë dhe krijohet ndjenja e bashkëpunimit dhe kolektivitetit.</i></li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Të kryhen lëvizje me amplitudë të madhe dhe të mbahet ushtrimi sa më gjatë.</i></li> <li>▪ <i>Të kryhen lëvizje të lirshme dhe të gjendet ritmi i përshtatshëm për të vrapuar gjatë</i></li> <li>▪ <i>Të vrapohet gjatë pa kaluar në dihatje, mundësisht pa kaluar në ecje</i></li> </ul>	<p><b>A.</b> Përmirësim i largësisë në vrapim të pandërprerë për 6 min duke bashkërenduar mirë frymëmarrjen dhe me lëvizje harmonike</p> <p><b>B.</b> Përmirësim i vogël ose nuk kryen lëvizje harmonike</p> <p><b>C.</b> Veprimet dhe frymëmarrja nuk janë harmonike dhe përmirësimi mjaft i vogël</p>



1.3	Vrapime me pengesa	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kalim me vrapim i 2-3 pengesave të ulta 40-50 cm, me largësi të papërcaktuara ndërmjet tyre (10-12m)</li> <li>▪ Mbështetje e njëres këmbë në një mur apo shpinore, luhatje e krahëve me numërime si në ritmin e kalimit të pengesës me tre hapa, përkulje mbi këmbë dhe prekje e saj me dorën e kundërt.</li> <li>▪ Mbështetur me të dy duart në mur apo shpinore, tërheqje e këmbës shtytëse mbi pengesë.</li> <li>▪ Kalim anash me ecje i 3-5 pengesave.</li> <li>▪ Me nisje në këmbë kalim i tre pengesave me 3-5 hapa.</li> </ul> <p>Njohuri të përgjithshme për rregulloren e ecjes dhetë vrapimeve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të krijohet mendimi për ta sulmuar larg pengesën.</li> <li>▪ Të bashkërendohen lëvizjet e këmbëve me të duarve.</li> <li>▪ Të bëhet mbledhje e shpejtë e këmbës shtytëse para gjoksit.</li> <li>▪ Të bashkërendohen lëvizjet e këmbëve me të duarve.</li> <li>▪ Të rregullohet largësia ndërmjet pengesave e tillë që të kalohen rrjedhshëm.</li> <li>▪ Të formohet një kulturë e përgjithshme teorike.</li> </ul>	<p><b>A.</b> Kalon pengesat rrjedhshëm, me një përkulje të lehtë të trupit dhe pa ndryshime të shpejtësisë.</p> <p><b>B.</b> Ka ndonjë mangësi në lëvizjet e këmbës shtytëse a sulmuese ose mban drejt trupin.</p> <p><b>C.</b> Prish hapat para pengesës, ulet shpejtësia pas kalimit të pengesës ose nuk i bashkërendon mirë krahët me këmbët.</p>
1.4	Njohuri			
2 2.1	<b>KËRCIMET</b> <b>Kërcimi së gjati</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Me pak vrull, rrahje, prekje me kokë e objekteve të varura në lartësi.</li> <li>▪ Kërcime radhazi mbi 3-4 pengesa të ulta (20-30cm).</li> <li>▪ Kërcime të plota me vrull 8-12 hapa me teknikën 1,5 hapa.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të bëhet rrahja me gjithë shputën dhe të drejtohet trangu.</li> <li>▪ Të krijohet një kënd sa më i madh ndërmjet kofshëve, të vazhdojë bashkërendimi krahë- këmbë si në vrapim dhe të ruhet sa më gjatë ky pozicion.</li> <li>▪ Të përvetësohen elemente të teknikës së kërcimit me 1,5 hapa.</li> </ul>	<p><b>A.</b> Kërcim i rrjedhshëm, flurudhë e lartë kërcimi, kontroll i mirë i lëvizjeve</p> <p><b>B.</b> Prishje e hapave gjatë vrullit, rrahje jo e plote apo flurudhë e ulët.</p> <p><b>C.</b> Veprime të dobëta, jo të rrjedhshme, nuk ka ndjesinë e kërcimit (fluturimit).</p>

